



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.60

Prishtinë, më 2.8.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-II

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Shpejtim Bulliqi, Ismajl Kurteshi dhe Sërgjan Popoviq.

Munguan: Bekim Haxhiu, Mufera Shinik, Teuta Haxhiu dhe Shukrije Bytyçi.

Pjesëmarrës të tjerë: Përfaqësues të KDI –së dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të datës 13.7.2016;
3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-113 për Ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, Kosovë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, Programi Fullbright i Shkëmbimit Akademik;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës rinisë dhe sportit;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për **Parandalimin** dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi i mbledhjes konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të datës 13.7.2016;

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 13.7.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-113 për Ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, Kosovë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, Programi Fullbright i Shkëmbimit Akademik;

Kryetari i Komisionit tha se Projektligji për Ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, Kosovë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës Programi Fullbright i Shkëmbimit Akademik, ka për qëllim nxitjen e bashkëpunimit të institucioneve arsimore, shkencore dhe kërkimore në të dyja shtetet, inkurajimin dhe përmirësimin e kualifikimeve të profesionistëve akademikë, studiuesve, mësimeve dhe studentëve si dhe promovimin e projekteve kërkimore të përbashkëta.

Komisioni shqyrtoi Projektligjin për Ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, Kosovë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës Programi Fullbright i Shkëmbimit Akademik dhe vendosi që Kuvendit, t'ia paraqet këtë

R e k o m a n d i m

- I.** Të miratohet Projektligji për Ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, Kosovë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës Programi Fullbright i Shkëmbimit Akademik, me amendamentet e propozuara si vijon:

Amendamenti 1

Fshihet teksti si vijon:

KAPITULLI I:

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Amendamenti 2

Neni 2, fshihet teksti si vijon: **“dhe për autoritetet tjera kompetente, që janë përgjegjëse në fushën e arsimit të lartë”.**

Amendamenti 3

Pas nenit 2 të Projektligjit shtohen neni i ri si vijon:

Dokumentet e bashkëngjitura

Pjesë përbërëse e këtij ligji është Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë, Kosovë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, Programi Fullbright i Shkëmbimit Akademik.

Komisioni me shumicë votash, miratoi amendamentet e propozuara, dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e Projektligjit për Ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, Kosovë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës Programi Fullbright i Shkëmbimit Akademik.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës rinisë; dhe sportit
5. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive.

Kryetari, i njoftoi anëtarët e Komisionit se pika e katërt e rendit të ditës: Shqyrtimi i Projektligjit për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës rinisë dhe sportit dhe pika e pestë e rendit të ditës: Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive, të shtyhen për mbledhjen e radhës me qëllim të angazhimi të ekspertit nga ana e Komisionit.

6. Të ndryshme

Kryetari, tha se në kuadër të planit të punës së Komisionit për vitin 2016, është paraparë mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë. Në kuadër të aktiviteteve për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit, OJQ “Demokracia Plus” ka shpreh gatishmërinë për mbështetje të Komisionit gjatë realizimit të mbikëqyrjes.

Komisioni nxori vendim për themelimin e Grupit Punues për monitorimin e Ligjit nr. 03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë në këtë përbërje: Salih Morina kryesues, Nait Hasani, Ismajl Kurtishi dhe Sërgjan Popoviq anëtarë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:55.

E përgatiti: Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani